



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 tetor 2021

Nr.ref.:RK 1873/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI70/20

Parashtrues

Rasim Shabani dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev.
nr. 28/2020], i 11 shkurtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rasim Shabani, Hasim Shabani dhe Hashim Shabani, me adresë të përhershme në Fushë-Kosovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga avokati Selman Bogiqi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 28/2020], të 11 shkurtit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 21 [Parimet e përgjithshme], 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 prill 2020, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 27 maj 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga avokati që të dorëzojë autorizimin që dëshmon që i përfaqëson parashtruesit e kërkesës.
8. Më 8 qershor 2020, avokati e dorëzoi autorizimin e kërkuar në Gjykatë.
9. Më 4 qershor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrim të kërkesës.
10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH70/20, emëroi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilat ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
14. Më 2 qershor 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.
15. Më 4 qershor 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të sjellë dosjen e plotë të rastit.
16. Më 9 qershor 2021, Gjykata pranoi dosjen e plotë të rastit.
17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 7 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

19. Më 1 qershor 2004, Departamenti për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i Komunës së Fushë-Kosovës përmes Vendimit nr. 58, përkatësisht përmes Aktvendimit plotësues [06. nr. -58/2], duke u bazuar në nenin 15 të Ligjit mbi Ekspropriimin, e shpronësoi ngastrën kadastrale nr. 373 nga paraardhësi i parashtruesve të kërkesës, me qëllim që t'i sigurohet tokë Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.
20. Më 1 shkurt 2005, Departamenti për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i Komunës së Fushë-Kosovës nxori Aktvendimin plotësues [nr. 58/2] dhe vendosi që ngastra kadastrale nr. 373 të eksproprijohet me kompensim monetar.
21. Në procedurën administrative të udhëhequr pranë Kuvendit Komunal të Fushë-Kosovës, nuk është arritur pajtueshmëri mes palëve në këtë kontest për kompensimin e vlerës së paluajtshmërisë të eksproprijuar.

22. Si rezultat i kësaj, më 20 shtator 2005, organi administrativ i Fushës-Kosovës kontestën e kësaj natyre e paraqiti në Gjykatën Komunale për zgjidhje konform nenit 52 të Ligjit mbi Eksproprijimin.
23. Shkresat e këtij kontestit për shqyrtim, gjykata përkatëse i ka pranuar më 7 tetor 2005.
24. Më 8 maj 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktvendimit [nr. 498/2005], duke u bazuar në nenet 99, 100 dhe 102 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK): (i) ktheu propozimin e paraqitur për plotësim, duke kërkuar nga Komuna e Fushë-Kosovës – Shërbimi Pronësor Juridik që brenda 3 (tre) ditësh të sjellë Aktvendimin plotësues [06. nr.-58/2] të 1 shkurtit 2005, me vulë të plotfuqishmërisë; dhe (ii) detyroi Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që të dorëzojë të gjitha shkresat e lëndës dhe përgjigjen në formë të shkruar.
25. Më 27 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktvendimit [N. nr. 498/2005] ndërpreu procedurën për shkak të vdekjes së propozuesit, përkatësisht pronarit të ngastrës SH. SH. dhe vendosi që procedura të vazhdojë me propozimin e palëve në kuptim të nenit 277 të LPK-së.
26. Më 13 maj 2014, parashtruesit e kërkesës, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të SH. SH., të shpallur me Aktvendimin [O. nr. 380/11] e Gjykatës Komunale në Prishtinë, dega në Graçanicë, iu drejtuan Gjykatës Themelore në Prishtinë që procedura e ndërprerë më 27 qershor 2012 të vazhdohet, duke kërkuar që të caktohet një ekspert për caktimin e vlerës së çmimit të tregut të patundshmërisë së eksproprijuar.
27. Gjykata Themelore në Prishtinë aprovoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës dhe caktoi ekspertin që të bëjë ekspertizë lidhur me përcaktimin e vlerës së çmimit të tregut për ngastrën e eksproprijuar.
28. Më 11 gusht 2014, eksperti paraqiti ekspertizën e tij përmes së cilës vlerësoi se vlera e përgjithshme e ngastrës për kompensim është prej 490.568.00 € (katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro).
29. Më 26 shkurt 2015, parashtruesit e kërkesës gjatë zhvillimit të kontestit para Gjykatës Themelore në Prishtinë deklaruan se pajtohen me shumën e caktuar të ekspertit mbi ngastrën e eksproprijuar, por kërkuar që gjykata përkatëse të njeh të drejtën e kamatës në lartësi prej tetë përqind (8%) prej ditës së marrjes së aktvendimit deri në pagesën definitive.
30. Më 26 shkurt 2015, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [N. nr. 498/05] dhe duke u thirrur ekskluzivisht në nenin 28 [Lartësia e Shpërblimit] të Ligjit mbi Eksproprijimin dhe në nenin 13 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Eksproprijimit urdhëroi që parashtruesve të kërkesës t'u paguhet kompensimi nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës në emër të shpronësimit. Gjykata Themelore e përcaktoi shumën që duhej paguar prej 490.568.00 € (katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro), me kamatë të cilën e aplikojnë bankat për mjetet e afatizuara mbi 1 (një) vit, pa destinim prej 11 gushtit 2014, kur është bërë ekspertiza, si dhe

shpenzimet e procedurës prej 1.150.00 euro, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

31. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore. Ndër të tjera, sipas Gjykatës së Apelit, ankuesit gjatë procedurës së ankimit nuk kishin kontestuar lartësinë e çmimit të ofruar nga ekspertiza, por kundërshtuan caktimin e pagesës për shkak të gjendjes financiare të kompanisë.
32. Më 14 tetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 2090/15] refuzoi ankesën e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, si të pabazuar.
33. Më 27 nëntor 2019, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit përkitazi me kamatën e gjykuar, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatave të rregullta sepse me rastin e llogaritjes së kamatës nuk janë aplikuar dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktvendimit të atakuar.
34. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksuan para Gjykatës Supreme se *“Me kamatë të cilën e aplikojnë bankat për mjetet e afatizuara mbi 1 (një) vit, pa destinim prej 11 gushtit 2014, kur është bërë ekspertiza, është në kundërshtim me nenin 16, para.2 pika2.2 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme”*.
35. Parashtruesit e kërkesës përmes revizionit të paraqitur pretenduan se *“Neni 16, paragrafi 2 pika 2.2 parasheh si vijon: “interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore”. Sipas tyre, “kjo përqindje prej 7% interes i thjeshtë vjetor do t’ju takonte propozuesve nga data e hyrjes në fuqi e vendimit përfundimtar, vendimi i shpronësimit i datës 01.02.2005 deri të pagesa definitive”*.
36. Më 11 shkurt 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 28/2020], duke u bazuar në nenin 211.2 të LPK-së refuzoi si të palejuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, me arsyetimin se revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 euro.
37. Ndër të tjera, dhe për fund, Gjykata Supreme arsyetoi se *“Nga revizioni i propozuesve, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është goditur vetëm përkitazi me vendimin lidhur me kamatën e gjykuar. Në kuptim të neni 30.2 të LPK-së, kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat të tjera aksesore, nuk merren parasysh si vlerë kontesti në qoftë se nuk përbëjnë kërkesa të tjera aksesore, ku në rastin konkret kërkesa kryesore është regresimi i borxhit në shumën prej 69.371,63 euro, ndërsa kamata është kërkesë aksesore, kështu që në kuptim të*

paragrafit 1 të këtij neni si vlerë objekti të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore e jo edhe vlera e kamatës për të cilin është paraqitur revizioni”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Gjkata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme atyre u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rrëgjullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotja e pronës) të KEDNJ-së.
39. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Gjkata e shkallës së Parë, të Dytë dhe Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me kompensimin e kamatës për vlerën e të hollave për pronën e shpronësuar kanë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës duke iu mohuar të drejtën e kompensimit të kamatës sipas Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme të nenit 16, paragrafi 2, pika 2.2. Sipas kësaj dispozite, përqindja e kamatës për pronën e shpronësuar është 7%, interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore”.*
40. Më tutje, parashtruesit e kërkesës pohojnë si në vijim: *“Në rastin konkret palës drejtpërsëdrejti me aktvendimet e sipërcekura ju është cenuar e drejta e pronës së garantuar, ku prona është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ngase shpronësimi nuk ishte i menjëhershëm, procedura deri në kompensim është zvarritur mbi 14 vite dhe në fund gjykatat kamatën e gjykojnë gabimisht duke i dëmtuar pamasë këtu parashtruesit e kërkesës, edhe pse gjykatat tona rastet e tilla të shpronësimit i kanë gjykuar në vazhdimësi sipas ligjit duke e gjykuar kamatën me 7%”.*
41. Në vazhdim, parashtruesit e kërkesës pohojnë: *“Gjykata Supreme e Kosovës gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenit 212.2 dhe 30.2 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore duke u bazuar në faktin se revizioni nuk lejohet në kontestet civile në të cilat kërkesa ka të bëjë në të holla dhe po që se vlera e kontestit nuk kalon shumë prej 3,000.00 €. Në rastin konkret, vlera e borxhit kryesor është i njohur nga ana e gjykatës së bashku me kamatën, mirëpo është llogaritur sipas Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, e jo sipas Ligjit që është në fuqi nr. 03/L-139 për Shpronësim e pronës së paluajtshme, i cili Ligj është “LEX SPECIALIS” e që në rastin tonë është dashur të zbatohen dispozitat e të njëjtit me kamatë prej 7%”.*
42. Në këtë aspekt, ata theksojnë: *“Në praktikën juridike gjithmonë aplikohen dispozitat të cilat shkojnë në favor të palëve në procedurë e aq më shumë kur raporti i palëve ndërgjyqës është i rregulluar me ligj special”.*
43. Përgjatë pretendimeve, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Gjykata Supreme përveç dispozitave të lartpërmendura të nenit 212 të LPK-së gabimisht ka interpretuar edhe nenin 30. 2 të LPK-së ku thotë se kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat e tjera aksesore nuk merren parasysh nëse nuk përbëjnë kërkesë kryesore”.*

44. Sipas tyre: “[...] kjo dispozitë ligjore flet për përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, kur ushtrime padie e vendosim e përcaktojmë vlerën e objektit të kontestit sa i përket borxhit kryesor e ku në këtë vlerë nuk përfshihet kamata e të tjera vlera si aksesore, po citoj “Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padie ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore, pra jo edhe kamata. Andaj ne nuk ushtrojmë padie sepse çështja sipas padisë ka përfunduar, por ne me revizion kemi kërkuar mënjanimin e shkëljes sa i përket shumës së kamatës dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale”.
45. Në këtë aspekt, ata theksojnë se: “mbi bazën e këtij interpretimi Gjykata Supreme ka vepruar esencialisht në mënyrë të gabuar, ngase interpretimi i kësaj dispozite në rastin tonë fare nuk ka të bëjë aspak dhe nuk mund të trajtohet kërkesë aksesore. Ky qëndrim dhe interpretimi i Gjykatës Supreme nuk mund të qëndroj sepse në rastin tonë kamata është njohur dhe është gjykuar gabimisht kërkesës kryesore dhe se asesi nuk mund të trajtohet ashtu siç i ka vlerësuar Gjykata Supreme në vendimin e saj”.
46. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që (i) kërkesën e tyre të shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që vendimi i kontestuar, përkatësisht Aktvendimi [Rev. nr. 28/2020] i 11 shkurtit 2019 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me nenet 21, 31, 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[....]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet

drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

Ligji mbi Eksproprijimin (Gazeta Zyrtare KSAK Nr. 21/78, ndryshuar me Ligjin për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Eksproprijimin, Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 46/68, të 22 nëntorit 1986), të 28 prillit 1978.

“Neni 2b.

[...]

Procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të eksproprijuar është urgjente.

Kundër Aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni”.

Neni 28 **[Lartësia e Shpërblimit]**

[...]

“Çmimi i tregut i tokës së eksproprijuar bujqësore përcaktohet në bazë të dhënave mbi vlerën qarkulluese të cilat i jep shërbimi i të ardhurave shoqërore dhe të dhënave mbi shumën nga marrëveshjet që janë arritur për caktimin e kompensimit të drejtë për tokën e eksproprijuar në atë anë”.

Ligji nr. 03/l-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, 10 dhjetor 2010

Neni 16 **Pagesa e kompensimit**

1.Përveç siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kompensimi paguhet në Euro ose një valutë tjetër që mund të këmbehet lirisht.

2.Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtuesi i kërkesës ose Përfituesi i pritur – nëse ka të këtillë – që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë:

2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus;

2.2. interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.

3. Nëse një Person refuzon pranimin e këtij kompensimi, mjetet do të depozitohen në një xhirollogari mirëbesimi në BQK në emër të Personit në fjalë. Në rast të shfaqjes së kontestit mbi identitetin e Personit i cili ka të drejtën e pranimin të këtij kompensimi, mjetet do të depozitohen në një xhirollogari mirëbesimi në BQK në emër të një Përfituesi i cili mbetet të përcaktohet, ndërsa kontesti paraqitet pranë gjykatës kompetente për zgjidhje. Të gjitha mjetet e depozituara në një xhirollogari mirëbesimi konsiderohet se janë “paguar” për qëllime të këtij ligji.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

4. Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

Neni 30

30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.

30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore.

Pranueshmëria e kërkesës

47. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

49. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

50. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 28/2020], e 11 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

51. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNj) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
52. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, në

harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

53. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shpronësimin e pronës së parashtruesve të kërkesës nga Departamenti për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i Komunës së Fushë-Kosovës përmes Vendimit nr. 58, përkatësisht përmes Aktvendimit plotësues [06. nr. -58/2], duke u thirrur në nenin 15 të Ligjit mbi Eksproprijimin, me qëllim që t'i sigurohet tokë Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Në procedurën administrative të udhëhequr pranë Komunës së Fushë-Kosovës, nuk ishte arritur pajtueshmëri mes palëve për kompensimin e vlerës së paluajtshmërisë të eksproprijuar. Si rezultat i kësaj, më 7 tetor 2005, rasti u referua në Gjykatën Komunale në Prishtinë për zgjidhje.
54. Gjykata Komunale në Prishtinë fillimisht ndërpreu procedurën përmes Aktvendimit [N. nr. 498/2005] të 27 qershorit 2012, për shkak të vdekjes së propozuesit, respektivisht pronarit të ngastrës së shpronësuar dhe vendosi që procedura të vazhdojë me propozimin e palëve. Pas një kohe, përkatësisht më 13 maj 2014, parashtruesit e kërkesës, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të SH. SH., të shpallur me Aktvendimin [O. nr. 380/11] e Gjykatës Komunale në Prishtinë, dega në Graçanicë, iu drejtuan Gjykatës Themelore në Prishtinë që procedura e ndërprerë të vazhdohet duke kërkuar që të caktohet një ekspert për caktimin e vlerës së çmimit të tregut të pronës së eksproprijuar. Kërkesa për caktimin e ekspertit ishte aprovuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, e cila përmes Aktvendimit [N. nr. 498/05] të 26 shkurtit 2015, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi eksproprijimin të 22 nëntorit 1986 dhe në ekspertizën e ekspertit, urdhëroi që parashtruesve të kërkesës t'u paguhet kompensimi nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", në emër të shpronësimit në vlerë prej 490.568.00 € (katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro), me kamatë të cilën e aplikojnë bankat për mjetet e afatizuara mbi 1 (një) vit, pa destinim prej 11 gushtit 2014. Pas ankimit nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 2090/15] të 14 tetorit 2019 refuzoi ankesën e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe, në fund, vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme përkitazi me kamatën e gjykuar duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht aplikim të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta sepse me rastin e llogaritjes së kamatës nuk janë aplikuar dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktvendimit të atakuar, përkatësisht parashtruesit pretendojnë aplikim të gabuar të ligjit sepse me rastin e përcaktimit të kamatës nga Gjykata Themelore në Prishtinë nuk është aplikuar neni 16, paragrafi 2, pika 2.2 e Ligjit nr. 03/l-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, të 8 majit 2010, i ndryshuar dhe i plotësuar përmes Ligjit nr. 03/l-205, më 10 dhjetor 2010, i cili nen sipas tyre përcakton përqindjen e kamatës për pronën e shpronësuar 7% interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore. Mosaplikimi i këtij neni, respektivisht i kamatës 7% (shtatë përqind) në rastin e tyre, parashtruesit e kërkesës e kishin ngritur si pretendim përgjatë gjithë procesit gjyqësor para Gjykatës Supreme. Megjithatë, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 28/2020] e hodhi

poshtë revizionin e parashtruesve të kërkesës si të palejuar në kuptim të nenit 212 dhe 30 të LPK-së. Këtë konstatim të Gjykatës Supreme dhe mosaplikueshmëria e kamatës 7% (shtatë përqind) në rastin e tyre, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë edhe para Gjykatës.

55. Këto pretendime, parashtruesit e kërkesës i ngritin para Gjykatës, duke pretenduar në esencë, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së për shkak të aplikimit dhe interpretimit qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit, përkatësisht (i) moszbatim të Ligjit nr. 03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, të 10 dhjetorit 2010, përkitazi me kamatën dhe (ii) aplikim të gabuar të nenit 211.2 dhe 30.2 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore në rrethanat e rastit të tyre, përkitazi me refuzimin e revizionit nga Gjykata Supreme.
56. Me qëllim të analizimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës të shtjelluara më lart, duke elaboruar rrethanat e rastit konkret, Gjykata edhe një herë rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e nenit 21, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së si rezultat i aplikimit dhe interpretimit qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit, përkatësisht (i) zbatimit të ligjit të gabuar në rrethanat e rastit të tyre, më saktësisht (i) moszbatim të duhur të Ligjit nr. 03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, të 10 dhjetorit 2010, me rastin e përcaktimit të kamatës nga Gjykata Themelore, dhe (ii) aplikim dhe interpretim të gabuar të nenit 211.2 dhe 30.2 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore në rrethanat e rastit të tyre, përkitazi me refuzimin e revizionit nga ana e Gjykatës Supreme. Në vijim, Gjykata do t'i shqyrtojë të dy këto pretendime veç e veç.

(i) *Pretendimi për aplikim të gabuar të ligjit gjatë përcaktimit të vlerës së kamatës*

57. Përkitazi me pretendimin e parë, parashtruesit e kërkesës kontestojnë specifikisht vlerën e kamatës në rastin e tyre si rezultat i moszbatimit të ligjit të aplikueshëm në rrethanat e rastit të tyre, me rastin e përcaktimit të kamatës nga ana e gjykatave të rregullta, me arsyetimin e vetëm se nuk është aplikuar neni 16, paragrafi 2, pika 2.2 e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, të 8 majit 2010, i ndryshuar dhe i plotësuar përmes Ligjit nr. 03/L-205, më 10 dhjetor 2010, i cili nen sipas tyre përcakton kamatën **7 % për** pronën e shpronësuar, interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore. Sipas tyre, mosaplikimi i këtij neni, respektivisht i kamatës 7% (shtatë përqind) nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në rastin e tyre, përbën shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNj-së.
58. Gjykata fillimisht vëren se vlera e kamatës në rastin e parashtruesve të kërkesës ishte vendosur përmes Aktvendimit [N. nr. 498/05] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 26 shkurtit 2015.

59. Gjykata vëren poashtu se parashtruesit e kërkesës aktvendimin e lartcekur e kishin pranuar më 1 nëntor 2015, të cilin nuk e kishin kontestuar përmes ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit.
60. Përveç kësaj, Gjykata vëren se në përgjigjen e dorëzuar [N. nr. 498/05] në Gjykatën e Apelit nga parashtruesit e kërkesës më 26 prill 2015, kundër ankesës së paraqitur nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, kanë theksuar se Aktvendimi i Gjykatës Themelore nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të të drejtës procedurale dhe as asaj materiale.
61. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkatësisht pjesën e aktvendimit ku ishte vendosur përkitazi me vlerën e kamatës nuk e kishin kontestuar në Gjykatën e Apelit, ashtu siç e kanë kontestuar përmes revizionit në Gjykatën Supreme.
62. Nën dritën e kësaj, Gjykata vjen në përfundim duke u bazuar në shkresat e lëndës se pretendimi për çështjen e kamatës nuk rezulton të jetë ngritur përgjatë procedurave kontestuese para Gjykatës së Apelit.
63. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin formal dhe substancial.
64. Gjykata fillimisht thekson se, përderisa në kontekstin e makinerisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar, ky rregull zakonisht kërkon që ankesat e pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat 2478/15 dhe 1787/15, 16 korrik 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty).
65. Edhe më specifikisht, GJEDNJ mban qëndrimin se për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë pranë gjykatave të rregullta, kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty).
66. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve

kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Audulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafit 57).

67. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike për çështjen e kamatës të parashtruesve të kërkesës nuk janë ngritur/kontestuar para Gjykatës së Apelit, ajo konkludon që parashtruesit e kërkesës nuk u kanë dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, përkatësisht Gjykatës së Apelit, të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesit e kërkesës i ngrejnë drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre formal dhe substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-36).
68. Si rrjedhojë, për sa i përket këtij pretendimi, respektivisht: (i) pretendimit për aplikim të gabuar të ligjit përkitazi me caktimin e vlerës së kamatës, Gjykata konstaton se i njëjti duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit formal dhe substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) *Pretendimi për aplikim dhe interpretim të gabuar të ligjit me rastin e refuzimit të revizionit*

69. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata Supreme, ka aplikuar dhe interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 211.2 dhe 30.2 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore në rrethanat e rastit të tyre, përkitazi me refuzimin e revizionit nga ana e Gjykatës Supreme, kjo sipas tyre ka rezultuar në shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNj-së.
70. Në këtë drejtim, bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimi për zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
71. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës nr. KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të*

tjerët, Aktvendim për papranueshmerëi i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues X, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).

72. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNj, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmeri, i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart: KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37, dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
73. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastet e cituara më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
74. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNj-së ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin përkatës (shih rastet e GJEDNj-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rosisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Paduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57 dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shogëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
75. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës përmes revizionit kishin ngritur pretendime lidhur me çështjen e kamatës së vendosur përmes Aktvendimit [N. nr. 498/2005] të 26 shkurtit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të vërtetuar përmes Aktvendimit [Ac. nr. 2090/15] të 14 tetorit 2019 të Gjykatës së Apelit.

76. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 28/2020] të 11 shkurtit 2020, duke u bazuar në nenin 211.2 të LPK-së refuzoi si të palejuar revizionin e paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, me arsyetimin se revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 euro.
77. Më saktësisht, Gjykata Supreme në aktvendimin e saj lidhur me ankesën e parashtruesve të kërkesës, kishte arsyetuar:

“Në nenin 211.2 të LPK-së, parashihet që revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 euro. Nga revizioni i propozuesve, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është goditur vetëm përkitazi me vendimin lidhur -me kamatën e gjykuar. Në kuptim të nenit 30.2 të LPK-së, kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat të tjera aksesore, nuk merren parasysh si vlerë kontesti në qoftë se nuk përbëjnë kërkesën kryesore, ku në rastin konkret kërkesa kryesore është regresim i borxhit në shumë prej 69.371 ,63 €, ndërsa kamata është kërkesë aksesor, kështu që në kuptim të para. të këtij neni si vlerë e objektit të kontestit”.

78. Në kontekst të arsyetimit të Gjykatës Supreme, Gjykata i referohet nenit 30, të LPK-së, i cili përcakton:

“30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.

30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore”.

79. Gjykata vëren se Gjykata Supreme nuk është lëshuar në trajtim të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës përkitazi me kamatën duke konsideruar kërkesën e tyre si kërkesë aksesore dhe në fund e kishte hedhur poshtë si të palejuar.
80. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme përveç dispozitave të lartpërmendura të nenit 211 të LPK-së gabimisht ka interpretuar edhe nenin 30.2 të LPK-së ku thotë se kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat e tjera aksesore nuk merren parasysh nëse nuk përbëjnë kërkesë kryesore.
81. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “kjo dispozitë ligjore flet për përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, kur ushtrojmë padi e vendosim e përcaktojmë vlerën e objektit të kontestit sa i përket borxhit kryesor e ku në këtë vlerë nuk përfshihet kamata e të tjera vlera si aksesore”.

82. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në bazë të këtij interpretimi Gjykata Supreme ka vepruar esencialisht në mënyrë të gabuar, ngase interpretimi i kësaj dispozite në rastin konkret nuk mund të trajtohet si kërkesë aksesore, me arsyetimin se kamata është njohur dhe është gjykuar gabimisht.
83. Bazuar në atë si më lart, Gjykata ripërsëritë se Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës të cituar më lart, KI75/17, parashtrues X, paragrafi 59).
84. Megjithatë, bazuar në elaborimin e mësipërm, si dhe interpretimin dhe arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme, në rastin konkret, nuk është dëshmuar që ka arbitraritet në interpretimin e dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e hedhjes poshtë të revizionit të parashtruesit të kërkesës si të pajtuar.
85. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, arsyetimin e saj për hedhje poshtë të revizionit në mënyrë specifike e ka mbështetur duke u bazuar në nenin 30, paragrafin 2 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton që *"Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore"*.
86. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës, si rezultat i interpretimit dhe zbatimit të nenit 30, paragrafit 2 të LPK-së, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i "dispozitave ligjore" nga Gjykata Supreme, mund të këtë qenë "qartazi i gabuar", duke rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin e kërkesës, apo se si procedura para Gjykatës Supreme mund të mos këtë qenë e drejtë ose edhe të këtë qenë arbitrare.
87. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një Aktvendim i Gjykatës Supreme, sikurse ky i tanishmi, përmes së cilit ishin refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 euro. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, ka vlerësuar nëse tërësinë e procedurave të parashtruesit përkatës kanë përfituar nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm, duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material, duke qenë se kompetenca të tilla, siç është cekur më lart, janë nën juridiksionin primar të gjykatave të rregullta. Rastet e tilla, Gjykata i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku është kontestuar një vendim i Gjykatës Supreme që kërkesën për revizion e ka refuzuar në baza procedurale si të palejueshëm: KI66/18 parashtrues *Sahit Muçolli*, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018; KI110/16 parashtrues *Nebojša Đokić*, Aktvendim i 24 marsit 2017; KI24/16 parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim i 4 nëntorit 2016; KI112/14 parashtrues *Srboljub Krstić*, Aktvendim i 19 janarit 2015; KI84/13 parashtrues *Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj*, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).
88. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha

procedurave, Gjykata gjithashtu vëren që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).

89. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44; shih rastet e bashkuara KI150/15, KI161/15, KI162/15, KI14/16, KI19/16, KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
90. Gjykata rikujton se e drejta për një "*proces të drejtë*" në procedurat civile dhe penale, e cila kërkohet nga neni 6 i KEDNJ-së, nuk është drejtësi "materiale" por është drejtësi "procedurale". Në aspektin praktik kjo nënkupton se palët e kanë të drejtën për një procedurë kontradiktore në të cilën merren parasysh parashtruesat e palëve dhe në të cilën palët janë të vendosura në pozitë të barabartë para gjykatës (shih rastet e GJEDNJ, *Star Cate Epilekta Gevmata dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr. 54111/07, Vendimi i 6 korrikut 2010; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, nr. 74644/01, Vendimi i 7 marsit 2006, paragrafët 30-31).
91. Gjykata, në fund, rikujton se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
92. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si pasojë e aplikimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenin 212.2 dhe 30.2 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore me rastin e refuzimit të revizionit, janë gjithashtu qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
93. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sepse parashtruesit e kërkesës nuk dëshmojnë dhe nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre, dhe rrjedhimisht e njëjta nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Në pajtueshmëri me arsyetimin e këtij Aktvendimi, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31. 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si pasojë e (i) aplikimit të gabuar të

ligjit përkitazi me caktimin e vlerës së kamatës, Gjykata konstaton se i njëjti duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit formal dhe substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës; ndërsa (ii) interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm, respektivisht interpretimi dhe aplikimi i gabuar i nenit 211 dhe 30 të LPK-së, janë gjithashtu qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47. 2 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2021, me shumicë

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani